

# STATUT

## I SHOQERISE ME PERGJEGJESI TE KUFIZUAR

### “Inno Data” sh.p.k.

Sot ne daten **11.11.2019** , un ortaku themelues :

**Z. Vincenzo Santoro** , shtetas italian , i datelindjes **01/06/1977** , atesia **Giuseppe**, lindur ne **Napoli ( NA )** , banues ne **Via Roma 25-55049 Viareggio (LU )** , i pajisur karte identiteti italiane nr **CA96436DD** , leshuar me date **24/01/2019** , madhor e me zotesi te plote juridike per te vepruar.

Ne baze te ligjit nr.9901 date 14.04.2008 “Per Tregtaret dhe shoqerite tregtare” dhe ligjit nr.9723 date 03.05.2007 “Per Qendren Kombetyare te Regjistrimit”,hartoj Statutin e Shoqerise : **“Inno Data ” sh.p.k.** si me poshte :

#### NENI 1 EMERTIMI I SHOQERISE

Shoqeria do te quhet **“Inno Data” sh.p.k.** dhe eshte person juridik shqiptar

Veprimtaria e saj rregullohet sipas neneve te ketij statuti dhe Ligjit 9901 date 14.04.2008 si edhe Ligjit per QKR-en.

#### NENI 2 SELIA E SHOQERISE

**Shoqeria do te kete seline e saj ne Lagjja nr.1,Rruga Taulantia , nr pasurie 26/110+1-1/1 zk 8512, Durres.** Shoqeria mund te krroje filiale ,zyra perfaqesimi, ne perputhje me legjislacionin shqiptar.

#### NENI 3 OBJEKTI I VEPRIMTARISE SE SHOQERISE

Shoqeria do te kryej aktivitet si me poshte :

Shoqeria do te kete si objekt te veprimtarise se saj :

Sherbimi i kerkimit dhe mbledhja e informacionit tregtar ne emër të palëve të treta; Aktiviteti i importimit, futjes, azhornimit, përpunimit, eksportimit dhe analizës së të dhënave të strukturuar dhe të pa strukturuar për palët e treta; Projektimi, realizimi, instalimi dhe mirëmbajtja e bazave të të dhënave dhe software-t përkatës, që synojnë ofrimin e mjeteve to domosdoshme për analizimin e klienteles dhe tregut, si dhe mjete për gjenerimin e mundësive te reja te tregut; Organizimi i të dhënave në bazën e të dhënave, përfshirë verifikimin dhe vlerësimin e saktësisë, qëndrueshmërisë dhe tërësisë së të dhënave me qëllim lehtësimin e hyrjes ne bazen e te dhenave, nxjerrjes dhe interpretimit e ketyre te fundit;

Aktiviteti i përpunimit të të dhënave përmes integritimit, grupimit dhe normalizimit të të dhënave në bazën e të dhënave për një pamje me të plotë dhe të integruar të klienteles;

Menaxhimi i arkivimit, ruajtjes dhe procedurave të rigjenerimit dhe mbrojtjes së të dhënave; Aktiviteti i Big Data Analysis & Marketing përmes përdorimit të proceseve, mjeteve dhe teknologjive të nevojshme për të përpunuar informacionin e nevojshëm për përcaktimin e modeleve të analizës territoriale dhe modeleve parashikuese të sjelljes;

Realizimi i aktiviteteve të kërkimit, zhvillimit dhe konsulencës në fushën e sistemeve të informacionit të drejtuar nga të dhënat dhe me perberje të lartë teknologjike; Aktivitetet e Shërbimit drejt Konsumatorit (Customer Service) dhe Kujdesit drejt Konsumatorit (Customer Care), me suport telefonik dhe web, përfshirë aktivitetet e Telemarketingut dhe të metodologjise Quality Call për të zhvilluar mundësi të reja biznesi; Aktiviteti i backoffice, kontabilitetit dhe administratës në burimet e jashtme (outsourcing).

Kompania mund të kryejë të gjitha veprimet tregtare, industriale, mbi pasuritë e tundshme e te patundshme, operacionet financiare dhe bashkëpunuese të cilat konsiderohen të nevojshme nga organi administrativ për arritjen e qëllimit të kompanise.

Gjithashtu mund të kete, jo për qëllim vendosjeje, interesa dhe aksione direkte dhe indirekte në shoqeri ose kompani të tjera që kanë një objekt të ngjashëm ose të lidhur me të vetin.

Kompania, në mënyrë jo të shpeshtë e mbizotëruese dhe me funksion ekskluzivisht instrumental për arritjen e qëllimit të korporatës e cila gjithsesi vete përjashtohet në mënyrë të qartë ndaj çdo aktiviteti të kryer drejt publikut, mund të japë garantdhënie dhe garanci në favor të palëve të treta.

#### NENI 4

### KAPITALI I SHOQERISE

**Kapitali i shoqerise "Inno Data" sh.p.k. është 1.000 (njemije) leke**

**Ky kapital përbehet nga 1 kuote dhe zoterohet nga :**

**Z. Vincenzo Santoro që zoteron 100 % të vlerës të kapitalit të shoqerise të barabarta me vlerën 1.000 leke .**

#### NENI 5

### MENYRAT E FITIMIT DHE KALIMIT TE KUOTAVE

Kuotat e kapitalit të shoqerise dhe të drejtat që rrjedhin prej tyre mund të fitohen apo kalohen nëpërmjet

-Kontributit në kapitalin e shoqerise

-Shitblerjes

-Trashegimise

-Dhurimit

-Cdo mënyrë tjetër të parashikuar me ligj.

#### NENI 6

### ZMADHIMI E ZVOGELIMI I KAPITALIT THEMELTAR

Asambleja e Përgjithshme, me shumicë të kualifikuar, mund të zmadhojë kapitalin themeltar të shoqerise duke rritur kuotat e ortakeve ekzistues në shumën e përcaktuar në vendimin përkatës. Zmadhimi i kapitalit me qëllim

pranimin e ortakeve te rinj ne shoqeri, miratohet nga Asambleja e Pergjithshme me shumicen e kualifikuar te votave te ortakeve

Shoqeria mund te vendose zvogelimin e kapitalit themeltar te shoqerise me vendimin e Asamblese se Pergjithshme, te marre me shumice te kualifikuar te votave.

**NENI 7  
KOHEZGJATJA E SHOQERISE**

Shoqeria do te zhvilloje veprimtarine e saj per nje periudhe kohore te percaktuar.

**NENI 8  
ORGANET E SHOQERISE**

Asambleja e Pergjithshme

Administratoret

**NENI 9  
ASAMBLEJA E PERGJTHSHME**

Asambleja e Pergjithshme eshte pergjegjese per marrjen e vendimeve per shoqerine per ceshtjet e meposhteme :

- Percaktimin e politikave tregtare te shoqerise
- Ndryshimin e statutit
- Emerimin dhe shkarkimin e administratoreve
- Emerimin dhe shkarkimin e likujdueseve dhe te eksperteve kontabel te autorizuar
- Percaktimin e shperblimeve per administratorin, likujduesin dhe ekspertin kontabel
- Mbikeqyrjen e zbatimit te politikave tregtare nga administratoret, perfshire pergaditjen e pasqyrave financiare vjetore dhe te raporteve te ecurise se veprimtarise.
- Zmadhimin dhe zvogelimin e kapitalit
- Pjestimin e kuotave dhe anullimin e tyre.
- Perfaqesimin e shoqerise ne gjykate dhe ne procedimet e tjera ndaj administratoreve.
- Riorganizimin dhe prishjen e shoqerise.
- Miratimin e rregullave proceduriale te mbledhjeve te asamblese
- Ceshtje te tjera te parashikuara nga ligji apo statuti

**NENI 10  
MBLEDHJA E ASAMBLESE SE PERGJITHSHME. MENYRA E THIRRJES**

Mbledhja e asamblese mund te jete e zakonshme ose e jashtezakonshme

Asambleja e Pergjithshme thirret nga administratoret apo ortaket e percaktuar sipas nenit 84 te Ligjit





Asambleja e Pergjithshme thirret nga administratori te pakten 1 here ne vit,per miratimin e llogarive te shoqerise,por mbledhje te tjera mund te thirren gjate vitit per ceshtjet nga me te ndryshmet.

Mbledhja e Asamblese se Pergjithshme thirret nepermjet nje shkrese derguar cdo ortaku me poste te zakonshme ose mesazh elektronik.Njoftimi duhet te kryhet te pakten 7 dite perpara dates se caktuat per mbledhjen.

Kur Asambleja e Pergjithshme nuk eshte thirrur sipas pikes se mesiperme,ajo mund te marre vendime te vlefshme, vetem ne se te gjitha ortaket jane dakort,per te marre vendime pamvaresisht parregullise.

### **Kuorumi**

-Ne rastin e marrjes se vendimeve, qe kerkojne nje shumice te zakonshme,asambleja e pergjithshme mund te marre vendime te vlefshme vetem ne se marrin pjese ortaket me te drejte vote,qe zoterojne me shume se 30 per qind te kuotave.Ne rastin kur asambleja e pergjithshme duhet te vendose per ceshtje,te cilat kerkojne shumice te kualifikuar, sipas nenit 87 te ketij ligji,ajo mund te marre vendime te vlefshme vetem ne se ortaket qe zoterojne me shume se gjysmen e numrit total te votave qe jane te pranishem personalisht,votojne me shkrese,apo mjete elektronik sipas parashikimeve te pikes 3 te nenit 88 te ketij ligji.

-Ne se asambleja e Pergjithshme nuk mund te mblidhet per shkak te mungeses se kuorumit te permendur ne piken 1 te ketij neni, Asambleja mblidhet perseri jo me vone se 30 dite,me te njejten rend dite.

### **Marrja e vendimeve**

-Me perjashtim te rasteve kur statuti parashikon nje shumice me te larte, asambleja e pergjithshme vendos me tri te katertat e votave te ortakeve pjesemarrjes,sic percaktohet ne piken 1 te nenit 86 te ketij ligji,per ndryshimin e statutit,zmadhimin ose zvogelimin e kapitalit te regjistruar,shperndarjen e fitimeve,riorganizimin dhe prishjen e shoqerise.

-Me perjashtim te rasteve kur parashikohet ndryshe ne kete ligj ose ne statut,per ceshtje te tjera te renditura ne nenit 81 te ketij ligji, asambleja e pergjithshme vendos me shumicen e votave te ortakeve pjesemarrjes.

-Me perjashtim te rasteve kur parashikohet ndryshe ne kete ligj, vlefshmeria e vendimeve qe percaktojne detyrime shtese mbi ortaket, apo me vendimet qe kufizojne te drejtat e tyre,te parashikuara ne ligj,ose ne statut,kushtezohen nga miratimi i ortakut perkates.

-Te gjitha vendimet e asamblese duhet te regjistrohen ne proces verbal.

### **NENI 11 E DREJTA E VOTES**

Cdo kuote i jep ortakut te pranishem apo perfaqesuesit te tij te autorizuar te drejten e nje vote.

Asnje ortak nuk voton ne mbledhjen e asamblese se pergjithshme ne se nuk ka shlyer teresisht detyrimet,qe kane te bejne me kuotat, qe ai disponon.

### **NENI 12 ADMINISTRATORET.**

**Administrator i shoqerise do te jete Z. Vincenzo Santoro , shtetas italian , i datelindjes 01/06/1977 , atesia Giuseppe, lindur ne Napoli ( NA) , banues ne Via Roma 25-55049 Viareggio ( LU ) , i**

**pajisur karte identiteti italiane nr CA96436DD , leshuar me date 24/01/2019 , i cili emerohet per nje periudhe 5-vjecare, me te drejte ripërteritje.**

Administratori mund te shkarkohet ne cdo moment nga Asambleja, me shumice te thjeshte te votave, me kusht qe ne mbledhje te marrin pjese ortaket me te drejte vote, qe zoterojne me shume se 30% te kuotave. Statuti apo marreveshje te tjera nuk mund te perjashtojne apo kufizojne kete te drejte.

### **Neni 13 Kompetencat e administratorit**

Administratori ka te drejte dhe detyrohet :

- Te kryej te gjitha veprimet e administrimit te veprimtarise tregtare te shoqerise, duke zbatuar politika tregtare, te vendosura nga Asambleja e Pergjithshme.
- Te perfaqesoje shoqerine tregtare
- Te kujdeset per mbajtjen e sakte e te rregullt te dokumentave dhe te librave kontabel te shoqerise..
- Te beje te mundur pergatitjen nga specialisti i ngarkuar dhe te nenshkruaj bilancin parashikues per vitin e ardhshem, per tu miratuar nga Asambleja e pergjithshme, brenda dates 20 tetor te vitit paraardhes.
- Te beje te mundur pergatitjen nga specialisti i ngarkuar dhe te nenshkruaj bilancin vjetor te mbyllur , per tu miratuar nga asambleja e pergjithshme, brenda dates 20 Mars te vitit ardhshem dhe raportin e ecurise se veprimtarise dhe , se bashku me propozimet per shperndarjen e fitimeve, i paraqit keto dokumenta perpara asamblese se pergjithshme per miratim.
- Te krijojte nje sistem monitorimi e njoftimi te hershem per rrethanat qe kercenojne mbarevajtjen e veprimtarise dhe ekzistencen e shoqerise.
- Te kryej regjistrimet e publikimet e detyrueshme te te dhenave te shoqerise.
- Te raportoje perpara asamblese se Pergjithshme ne lidhje me zbatimin e politikave tregtare dhe me realizimin e veprimeve te posacme me rendesi te vecante per veprimtarine e shoqerise tregtare.
- Te kryej detyra te tjera, te percaktuara ne ligj dhe statut.

### **NENI 14 Shperndarja e fitimit vjetor te shoqerise**

Pjesa e fitimit qe i takon secilit ortak nga vlera e fitimit vjetor te deklaruar ne pasqyrat financiare te shoqerise, vendoset te shperndahet nga asambleja e pergjithshme.

Asambleja e Pergjithshme ka kompetence t'u shperndaje ortakeve pjesen e fitimit ne raport me vleren e kapitalit te regjistruar, qe kuotat e secilit ortak perfaqesoje.

Po ashtu, Asambleja e Pergjithshme mund te vendose qe nje pjese te fitimit vjetor te mos u shperndahet ortakeve, por keto shuma te perdoren per zmadhimin e kapitalit fillestar apo per qellime te tjera, te cilat ajo i konsideron te dobishme per shoqerine.

### **NENI 15 Prishja e shoqerise, largimi dhe perjashtimi i ortakeve**

Prishja e shoqerise

Shoqeria priset:



a)kur mbaron kohezgjatja e parashikuar ne themelimin e saj

b)me vendim te asamblese se pergjithshme

c)me hapjen e procedurave te falimentimit

c)nese nuk ka kryer veprime tregtare per dy vjet dhe nuk eshte njoftuar pezullimi i veprimtarise ne perputhje me pikën 3 te nenit 43 te ligjit nr.9723 date 03.05.2007 per "QKR".

d)me vendim te gjykates

dh)per arsye te tjera te parashikuara ne statut

#### **Largimi i ortakut**

-Ortaku mund te largohet nga shoqeria :

-nese ortakët e tjere ose shoqeria kane kryer veprime ne dem te tij

-nese eshte penguar te ushroje te drejtat e tij.

-ne se shoqeria i ka ngarkuar detyrime te paarsyeshme apo,per shkaqe te tjera,qe e bejne te pamundur vazhdimin e ortakërise

Perjashtimi i ortakut

Ne baze te nje vendimi te zakonshem, asambleja e pergjithshme mund ti kerkoje gjykates perjashtimin e ortakut,ne se ai nuk ka shlyer kontributin e tij,sipas parashikimeve te statutit, ose ne se ekzistojne shkaqe te tjera te arsyeshme per.kete perjashtim,te parashikuar ne ligj.

#### **NENI 16**

#### **Likujdimi i shoqerise**

Ne rast te likujdimit te shoqerise, Asambleja e Pergjithshme emeron nje likujdator, i cili administron shoqerine deri ne mbylljen e procesit te likujdimit.

Me vendimin e posacem te Asamblese se Pergjithshme,te marre me shumice te kualifikuar,pasi jane shlyer detyrimet ligjore ndaj kreditorëve te shoqerise, likujdatori shperndan pjesen e mbetur te pasurise se shoqerise ndermjet ortakëve.Kjo shperndarje e fundit behet ne raport me vleren e kapitalit te regjistruar,qe kuotat e secilit ortak perfaqesojne.

#### **NENI 17**

#### **Ftesa per kreditorët**

Likujduesit duhet te ftojne kreditorët per te depozituar pretendimet e tyre per prishjen e saj.Shoqeria e publikon dy here kete njoftim,me nje interval prej 30 ditesh, ne faqen e saj te internetit si dhe ne faqen e internetit te Qendres Kombetare te Regjistrimit.Ne njoftim duhet deklaruar se pretendimet duhet te depozitohen brenda 30 diteve nga data e njoftimit te fundit

#### **NENI 18**

#### **.Perfundimi i likujdimit**

Pas shperndarjes se aktiveve te mbetura, likujduesi e njofton Qendren Kombetare te Regjistrimit per perfundimin e likujdimit dhe kerkon crregjistrimin e shoqerise.

Veprimtaria e likujduesit nuk mund te kundërshtohet pas crregjistrimit te shoqerise nga Qendra Kombetare e Regjistrimit.

**NENI 19**  
**MOSMARREVESHJET**

Mosmarreveshjet zgjidhen me mirekuptim

Ne rast te kunder,ortaket themelues do ti drejtohen gjykates kompetente per zgjidhje.

**NENI 20**

Per sa nuk eshte parashikuar ne kete statut, do te behet referim ne dispozitat e legjislacionit tregtar dhe atij shqiptar ne pergjithesi.

**ORTAKU THEMELUES I SHOQERISE**

**“ Inno Data” sh.p.k.**

**Vincenzo Santoro**

Handwritten signature of Vincenzo Santoro in blue ink, consisting of a stylized cursive script followed by a large, bold letter 'S'.

**Perktheu: Saimir Zalla**

Handwritten signature of Saimir Zalla in blue ink, featuring a stylized cursive script.